



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 872 prot.

Tiranë, më 18. 06. 2018

Lënda: Mendime mbi Projektljin për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “*Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare*”, të ndryshuar.

Drejtuar: **Z. Ulsi MANJA**
KRYETAR I KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE,
ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Për dijeni: **Z. Petrit VASILI**
KRYETAR i KOMISIONIT PËR PUNËN , ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË

KUVENDI I SHQIPËRISË

TIRANË

I nderuar Kryetar,

Nga ana juaj është kërkuar mendim në lidhje me Projektljin për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “*Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare*”, të ndryshuar.

I) Sqarojmë se, më parë, Projektlji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “*Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare*”, ka ardhur për konsultim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përmes shkresës me Nr. 5114, datë 05.12.2017, me lëndë: “*Dërgohet për mendim projektvendimi për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar”*”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën Nr. 147, datë 26.01.2018, ka paraqitur sugjerime dhe komente lidhur me ketë projektligj, si më poshtë vijon:

Në nenin 3 tek “Përkufizimet” e ligjit nr. 9669/2006 “*Për Masa ndaj dhunës në marrëdhëniet Familjare*”, propozojmë të shtohet përkufizimi i “*Dhunës ndaj Grave*”, pasi dhuna ndaj gruas parashikohet si formë diskriminimi¹. Përkufizimi të jetë si më poshtë “*Dhunë Kundër Grave*” kuptohet: *si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkuption të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrale të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private.*

Në nenin 1, pika 4 të këtij projektligji, propozojmë të ndryshohet:

“Pas pikës 2, të shtohen pika 3 dhe 4 me përbajtjen, si më poshtë vijon:

3. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimate, sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, gjendje ekonomike, arsimore, ose shoqërore, shtatzënie, lindjeje, përkatësie prindërore, përgjegjësie prindërore, gjendjen familjare ose martesore, orientimi seksual, identiteti gjinor, vendbanimi, moshe, gjendje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigrant ose refugjati, përkatësia në një grup të veçantë, ose çdo shkak tjetër”.

Këto ndryshime në projektligji, lidhur me shkaqet e mbrojtura të diskriminimit, do të bëjnë të mundur që ligji “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, të jetë në përputhje me Ligjin 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrotjen nga Diskriminimi*” si dhe me Konventën “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

II) Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi konstaton se projektligji “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar*”, ka parashikime në përputhje me “*Konventën e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje*”. Komisioneri mbështet plotësisht harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me aktet ndërkombëtare.

Pasi u analizua Projektligji i ardhur për komente nga Kuvendi i Shqipërisë, propozohet:

Së pari, t’i kushtohet vëmendje e veçantë për mbrojtje edhe gruas.

Në nenin 1 pika 3 të projekt-ligjit para shtesës së propozuar: “... si dhe çdo grup tjetër, subjekt të këtij ligji, sipas nenit 3, të tij, që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje” dhe pas “...personave me aftësi të kufizuar”, të parashikuar në Ligjin 9669, të shtohet edhe “...grave”.

¹ Në përputhje me Konventën “*Për Parandalimin Dhe Luftën Kundër Dhunës Ndaj Grave Dhe Dhunës Në Familje*”.

Në vetë relacionin e projekt-ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, evidentohet përqasja dhe harmonizimi i këtij ligji me:

- Konventën e Këshillit të Evropës, “*Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*”;
- Konventën e Kombeve të Bashkuara, “*Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave*”;
- Detyrimet që burojnë nga BE për zgjidhjen e problemeve të evidentuara nga zbatimi i ligjeve në praktikë, të shtuara veçanërisht, gjatë kohëve të fundit.

Siq shihet Konventat e sipër cituara e vendosin theksin specifisht në dhunën dhe diskriminimin ndaj grave, prandaj specifikimi i tyre si një kategori veçanërisht e mbrojtur siç është bërë për fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, të bëhet edhe për gratë.

Së dyti, të shtohet përkufizimi i “*Dhunës ndaj Grave*”, pasi dhuna ndaj gruas parashikohet si formë e hapur diskriminimi².

Në nenin 2 të projektligjit, ndër të tjera, parashikohet harmonizimi, me nenin 3 të Konventës së Stambollit, sipas së cilës: “*dhunë në familje*” nënkuption të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autor i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimin”.

Rezulton se ky projektligj e parashikon ndryshimin e përkufizimit për “Dhunën në Familje”, në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës, “*Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*” (Konventa e Stambollit), por nuk e përfshin specifisht Dhunën ndaj Grave.

Komisioneri vlerëson se, me këtë ligj duhet të gëzoj mbrojtje edhe Dhuna ndaj Grave, si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave, në kuptimin e Konventës.

Së treti, të ndryshohet përbajtja e nenit 1 të projektligjit, ku në pikën 3 të parashikohen shprehimi i shkaqet e diskriminimit, në mënyrë që ata të mund të identifikohen drejtpërdrejtë në ligj, si shkaqe të mbrojtura. **Kështu, në nenin 1 të** projektligjit, ku parashikohet se:

“Në nenin 1 bëhen këto shtesa:

² Në përputhje me Konventën “*Për Parandalimin Dhe Luftën Kundër Dhunës Ndaj Grave Dhe Dhunës Në Familje*”.

4. Pas pikës 2 shtohen pikat 3 e 4, si më poshtë vijon:

“3. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi ose çdo shkak tjetër.”

KMD propozon qe dispozita të ketë përmbajtjen si më poshtë:

“3. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, gjendje ekonomike, arsimore, ose shoqërore, shtatzënie, lindjeje, përkatësie prindërore, përgjegjësie prindërore, gjendjen familjare ose martesore, orientimi seksual, identiteti gjinor, vendbanimi, moshe, gjendje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigrant ose refugjati, përkatësia në një grup të veçantë, ose çdo shkak tjetër”

Nëse legislatori zgjedh të mos citojë shkaqet diskriminuese, që mbrohen me ligj, sugjerojmë që të paktën, fjalia, siç është në ligj *“për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni* në fuqi lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi, që citohet përpara, përmes listës jo-shteruese të shkaqeve.

Së katërti, në pikën 4 të nenit 1 të projekt-ligjit ku parashikohet shtimi i pikës 4 në nenin 1 të Ligjit 9669, propozohet riformulimi si më poshtë:

4. “Masat mbrojtëse të parashikuara në nenin 10 të këtij ligji, si dhe ato të ndërmarrë nga Policia e Shtetit nëpërmjet UPMM-së, në lidhje me kategoritë që gjëzojnë mbrojtje të veçantë sipas pikës 2 të nenit 1 të këtij ligji, nuk konsiderohen diskriminim nëse zbatohen sipas kushteve të këtij ligji.

Përsa më lart, nuk kemi komente të tjera lidhur me ketë projektligj.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI



Robert Gajda